



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 15.07.2019, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".
3. Shqyrtimi nën për nën i projektligjit “Për mbrojtjen civile”.

**Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Korab Lita, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Alket Hyseni, Edmond Leka, Bashkim Fino, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Alban Zeneli, Adriatik Alimadhi, Elena Xhina, Andi Përmeti, Elda Hoti, Aurora Mara, Ediola Braha dhe Tom Doshi.

**Mungojnë:**

Vasilika Hysi dhe Damian Gjikhuri

**Të ftuar :**

Fjoralba Caka – Zëvendësministre e Drejtësisë

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor

Maksim Qoku - Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor

Illir Toska – anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor

Agnes Bernhard – drejtuesja e misionit EURALIUS

Petro Koçi - Zëvendësministër i Mbrojtjes

Haki Çako - Drejtor i Përgjithshëm i Emergjencave Civile (DPEC)

Ismail Shehu - Drejtor i Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore në Ministrinë e Mbrojtjes

Maksimiljan Dhima - Drejtor i Planifikimit dhe Koordinimit pranë DPEC-së.

## **HAPET MBLEDHJA**

**Ulsi Manja** – Mirëdita të gjithëve!

Ju kërkohet ndjesë për vonesën për arsye të një angazhimi tjetër që zgjati përtej orarit të parashikuar !

Meqenëse kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me çështjet që kemi në rendin e ditës, e deklaroj të hapur mbledhjen e Komisionit të Ligjeve.

Më lejoni paraprakisht, para se të vazhdojmë me rendin e ditës, t’i urojmë ditëlindjen kolegut tonë, Jurgis Çyrbja, edhe në emër të komisionit! Ta gëzosh ditëlindjen, i nderuar koleg! Edhe 100 vite të tjera! Stafi i komisionit është kujdesur për të ta uruar ditëlindjen siç duhet!

Bashkë me urimin për ditëlindjen e kolegut, dua t’u uroj edhe kolegëve, të ftuarve, medias një ditë dhe javë të mbarë pune!

Pa humbur kohë, fillojmë me çështjet e rendit të ditës. Sot kemi tri çështje shumë të rëndësishme për diskutim: shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë". Për këto dy projektligje komisioni ynë është komision përgjegjës. Relatore është kolegja Klotilda Bushka. Ka konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Drejtësisë zonja Fjoralba Caka, zëvendësministre.

Mirë se keni ardhur, zonja Caka!

Nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kemi të ftuar zotin Ardian Dvorani, kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Mirë se erdhët në komision, zoti Dvorani!

Gjithashtu, kemi të ftuar zotin Maksim Qoku, zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe zotin Ilir Toska, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sa herë kemi të bëjmë me paketën e ligjeve të reformës në drejtësi, si përherë, që nga fillimi e deri sa ta përmbyllim plotësisht zbatimin e reformës në drejtësi, nga misioni EURALIUS, kemi të ftuar zonjën Bernhard, drejtuesen e misionit.

Mirë se keni ardhur, zonja Bernhard!

Do të doja të thosha dy fjalë para se t’ia kaloj fjalën relatores. Të dyja këto ligje, ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe ligji për organet e qeverisjes së sistemit të

drejtësisë janë miratuar në vitin 2016. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, me 3 vendime të saj, vendimin nr. 41 të vitit 2017, vendimin nr. 34 dhe vendimin nr. 78 të vitit 2017 ka prishur disa krerë në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, le të themi ka shfuqizuar tërësisht kapitullin që ka të bëjë me masat disiplinore, si dhe ka ndërhyrë në disa nene të tjera në ligjin për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, që janë kryesisht çështje të karakterit të teknikës legjislative, por edhe të qartësisë ligjore të normës juridike në këto dy projektligje.

Referuar nenit 87 të Rregullores së Kuvendit, zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese merret në shqyrtim nga Këshilli për Legjislacionin menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Efektivisht, Këshilli i Legjislacionit në zbatim të nenit 87 i ka marrë në shqyrtim këto dy projektligje, por për faktin që dihet, se reflektimi i vendimeve nga Gjykata Kushtetuese kërkon shumicë të cilësuar prej 84 votash, u punua në Këshillin e Legjislacionit, u ndërpre puna përkohësisht për arsye që dihen edhe të bojkotit të opozitës, dhe sot në Komisionin e Ligjeve kemi një produkt përfundimtar të Këshillit të Legjislacionit.

Në Këshill kanë kaluar të dyja këto projektligje. Janë reflektuar rekomandimet e tri vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, por i takon Komisionit të Ligjeve për t'i kaluar sipas procedurës së përcaktuar në Rregullore, dhe pastaj për t'ia adresuar seancës plenare.

Për të bërë prezantimin e projektligjit të parë "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", po ia kaloj fjalën relatores, zonjës Bushka, e cila, do të bëjë një përmbledhje dhe relativitet për të dyja projektligjet dhe pastaj do të kalojmë në pyetje dhe diskutime.

Fjala për ju.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti kryetar!

Në radhë të parë, para se të bëj një përmbledhje të dy nismave ligjore, do të doja të shprehja falënderim dhe mirënjohje për bashkëpunimin midis maxhorancës dhe opozitës në këtë proces!

Ka qenë proces shumë profesional dhe i orientuar ndaj interesit publik, ku, në fakt, një model bashkëpunimi arriti të nxirrte si produkt në Këshillin e Legjislacionit të dyja nismat që janë shpërndarë te ju. Ekspertët e të dyja palëve kanë punuar ngushtësisht me njëri-tjetrin edhe me ekspertët e EURALIUS-it, që kanë qenë me ne qysh prej fillimit të këtij procesi, për të nxjerrë dy produkte, që shpresoj se sot do të marrin edhe miratimin tuaj jo vetëm për cilësinë dhe dakordësinë që kanë, por edhe për faktin se lehtësojnë të gjithë atë që e konsiderojmë zbatimin sa më të shpejtë të komponentëve të reformës në drejtësi.

Pa humbur kohë, po ju paraqes se ku konsistojnë nismat: në radhë të parë, të gjithë jemi në dijeni të faktit se Gjykata Kushtetuese me 3 vendime ka shfuqizuar disa nene të ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë dhe disa nene të ligjit për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

E kemi detyrim nga Kushtetuta që të adresojmë nenet e shfuqizuara me vendim të Gjykatës Kushtetuese dhe t'i plotësojmë ato me dispozita të reja, në frymë të asaj që ka arsyetuar edhe Gjykata Kushtetuese dhe pikërisht Këshilli i Legjislacionit këtë proces ka nisur, i cili ka prodhuar nga një nismë për secilin ligj, që është prekur nga kjo gjykatë.

Më tej, në Komisionin e Ligjeve, i cili është komisioni përgjegjës, pasi është marrë njoftimi për nismat, është ngritur një grup pune me përfaqësues të institucioneve të reja të drejtësisë, ekspertët e EURALIUS-it dhe është punuar me nismën në mënyrë që reflektimeve t'u jepet forma përfundimtare.

Në të dy nismat, përveç faktit të plotësimin të neneve, të cilat janë cenuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese, janë bërë edhe formulime të tjera të pasaktësive teknike dhe korrigjimeve në disa nene, sepse vetë Gjykata Kushtetuese në vendimin përkatës ka shprehur tekstualisht që "Përveçsa konstatohet, ligjvënësit i sugjerohet që në procesin e rishikimit të ligjit "Objekt kundërshtimi" të marrë në konsideratë nevojën për përmirësimin në tërësi të terminologjisë së përdorur në hartimin e normave ligjore për të garantuar pajtueshmërinë e tij me Kushtetutën dhe me qëllim qartësimin e normave të ligjit".

Bazuar në këtë, janë bërë edhe disa reflektime të nevojshme të korrigjimeve teknike, të konstatuara në nene të caktuara, të cilat do t'u paraqesim gjatë kohës që do të kalojmë në shqyrtimin nen për nen.

Nga ana tjetër, në grupin e punës janë diskutuar edhe çështje të tjera që kanë lindur gjatë zbatimit të reformës, por që kanë lidhje me çështjet që kanë prekur vendimet e Gjykatës Kushtetuese, madje ka edhe formulime për ta bërë ligjin të zbatueshëm dhe për t'u lehtësuar në praktikë zbatimin e ligjit organeve të reja të drejtësisë.

Kuvendi e ka detyrim, edhe për publikun, por edhe për anëtarët e Komisionit të Ligjeve, që çdo nismë që ka të bëjë me rishikimin apo me plotësimin e dispozitave ligjore për ligjet e reformës në drejtësi, të ftoj institucionet e reja të drejtësisë, që të japin në mënyrë të detyrueshme opinion për legjislacionin.

Pra, në njëfarë mënyre, duke u bazuar te parimi i pushteteve të pavarura, Kuvendi nuk mund t'i kalojë nismat pa marrë më parë mendimin e këtyre institucioneve në mënyrë të arsyetuar, detyrim ky i nenit 93 i ligjit për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ku parashikohet detyrimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të shprehur mendime dhe për të bërë

propozime lidhur me ndryshimet në legjislacion, të cilat ndikojnë në punën e gjyqësorit, si dhe për çdo çështje tjetër që është në përgjegjësinë e këtij Këshilli. I njëjti parashikim reflektohet edhe në nenin 187 të të njëjtit ligj për Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Jua them këto pikërisht për t'ju treguar se jo vetëm detyrimet që ne kemi si Kuvend, por edhe për t'ia bërë të njohur opinionit publik se tashmë, në kuadër të reformës në drejtësi, parimet e paanësisë dhe të pavarësisë së pushteteve nga njëri-tjetri jo vetëm janë sanksionuar me dispozita ligjore, por edhe po gjejnë zbatim në praktikë.

Për t'i hyrë thelbit të nismave nëse i referohem ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, ky ligj synon të garantojë procesin e emërimit dhe të promovimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, bazuar në kritere transparence, objektive dhe meritokracie; përcakton në mënyrë të detajuar procedurat që sigurojnë përzgjedhjen e kandidatëve për magistratë dhe konfirmimin e tyre në karrierë, duke u bazuar në kritere objektive dhe transparente; sanksionimin e qartë dhe të plotë të të drejtave dhe detyrimeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe pajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit; rikonceptimin e sistemit të trajtimit vazhdues dhe vlerësimin periodik të gjyqtarëve dhe prokurorëve për efekt karriere, duke zgjeruar dhe forcuar më tej kriteret objektive për matjen e aftësive; detajimin e të gjitha shkeljeve disiplinore që kryejnë gjyqtarët apo prokurorët dhe sanksionet proporcionale në përputhje me shkeljet, duke e orientuar sistemin e përgjegjësisë disiplinore mbi kritere sa më objektive.

Gjithashtu, ligji ka synuar rikonceptimin e procedimit disiplinor, duke e shndërruar në një sistem garantues ku janë të ndara përgjegjësitë e institucioneve që kryejnë hetimin, institucioneve që marrin vendimin dhe institucioneve që shqyrtojnë ankimin e ushtruar ndaj vendimeve për masat disiplinore, me qëllim garantimin e parimit të një procesi të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 34, të vitit 2017, ka pranuar pjesërisht kërkesën e Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë, për shfuqizimin e disa dispozitave të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve” dhe ka vendosur shfuqizimin e disa normave që kanë të bëjnë me papajtueshmëritë ambientale, me transferimin pa pëlqim të magistratëve, veprimtaritë jashtë funksionit; pushimet vjetore; uljen e ngarkesës; kohëzgjatjen në detyrë të magistratit; nivelet e vlerësimit të magistratëve; shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit; ato që kanë të bëjnë me çështjet e veprimtarisë; shkeljet që lidhen me veprimtari jashtë funksionit; shkeljet disiplinore për shkak të veprës penale dhe pezullimin mbi bazë diskrecioni.

Për të gjitha këto në draftet që ne kemi punuar, ju keni të adresuara nenet përkatëse dhe se si ne kemi sugjeruar të plotësohen.

Të nderuar kolegë,

Përpara keni një tabelë për secilin ligj. Tabela është e ndarë në 3 kolona, për lehtësi studimi dhe kuptimi për të gjithë ne. Në kolonën e parë keni të paraqitur nenin e shfuqizuar ose siç është aktualisht, në tabelën e dytë është si e ka propozuar rishikimin Këshilli i Legjislacionit dhe në kolonën e tretë është si sugjerohet të jetë formulimi nga ana e grupit që punoi në lidhje me këto dy nisma.

Në ligjin për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Mund të prisni sa të mbaroj relatimin?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” përcakton parimet dhe rregullat në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, si dhe të Shkollës së Magjistraturës, që janë organe të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Edhe ky ligj ishte objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese dhe me vendimet nr. 41/2017 dhe nr. 78/2017 janë shfuqizuar disa dispozita, të cilat konkretisht kanë të bëjnë me shkeljet disiplinore të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe dispozitat që kanë të bëjnë me funksionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë sa u takon kompetencave të tyre, kur veprojnë si organ kolegjal në mbledhje plenare dhe në komisione për çështje të caktuara.

Janë shfuqizuar edhe disa nene të tjera, që kanë të bëjnë me vendimmarrjen për përjashtimin e anëtarëve të këshillave në rastin e konflikteve të interesit, të cilat sipas Gjykatës Kushtetuese duhet të riformulohen. Po në të njëjtat vendime parashikohet edhe sugjerimi dhe orientimi që bën Gjykata Kushtetuese, që ligjvënësi në tërësi ta shohë të gjithë ligjin nëse ka papajtueshmëri dhe paqartësi të normës, me qëllim që të bëhet i zbatueshëm në praktikë. Në këtë kuadër ka punuar i gjithë grupi i punës, duke zbatuar pikërisht këto orientime të Gjykatës Kushtetuese, siç jua shpjegova edhe pak më parë, rishikimin teknik të disa formulimeve që janë të paqarta gjatë zbatimit në praktikë, si dhe adresimin e dy çështjeve që kanë të bëjnë me pasaktësinë ose me nevojën emergjente, prandaj është parë e udhës të rishikohen në këtë moment për sa kohë të gjithë biem dakord.

Unë jam e hapur për pyetje.

Zoti kryetar, grupi i punës ka punuar gjatë gjithë javës, prandaj do të doja t’i falënderoja të gjithë përfaqësuesit e Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, përfaqësuesit e EURALIUS-it, të cilët kanë qenë të pranishëm në grupin e punës! Ne kemi zhvilluar sesione,

mbledhje të regjistruara në audio, duke ruajtur praktikën e mëparshme të të gjitha ligjeve të reformës, me qëllim, që nëse në të ardhmen do të ketë ndonjë paqartësi për interpretimin e normës të jenë të gjitha diskutimet dhe kushdo subjekt i interesuar ta kuptojë se cila ka qenë fryma dhe qëllimi i legjislatorit në momentin e hartimit të normës.

Ju falënderoj të gjithëve për punën dhe kontributin që keni dhënë dhe shpresoj në miratimin e këtyre drafteve nga ana e kolegëve të komisionit!

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Bushka për relatimin e të dy projektligjeve!

Fillojmë me projektligjin e parë “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96, të vitit 2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Edhe pse relatorja na e shpjegoi faktin që është punuar në grup pune me të gjithë përfaqësuesit e institucioneve, të cilët i kemi prezent sot në mbledhjen e komisionit, varianti që kemi përpara është një variant i dakordësuar me gjithë grupin e punës.

Për procedurë dhe në zbatim të Rregullores, duke shfrytëzuar rastin që i kemi sot prezent, pas relatimit, Ministria e Drejtësisë, si pjesë e grupit të punës, është konsultuar besoj me draftin e parë, me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Para se të kalojmë në fazën e pyetjeve dhe të diskutimeve do të doja një opinion të përfaqësuesve që janë të pranishëm.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, a jeni dakord?

**Fjoralba Caka** – Përshëndetje, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ligjeve,

Për mua është kënaqësi të jem sot këtu në emër të Ministrisë së Drejtësisë dhe t’ju përgëzoj për punën që është bërë në zbatim të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Në fakt, mbledhja e komisionit, po ashtu e Këshillit Legjislativ për të reflektuar detyrimet që burojnë nga Rregullorja dhe nga Gjykata Kushtetuese ka qenë një domosdoshmëri që ka lindur që në vitin 2017, por sikundër është theksuar edhe nga zoti kryetar, situatat politike e kanë vështirësuar miratimin e këtyre ndryshimeve, të cilat kërkojnë një shumicë të cilësuar.

Megjithatë, fakti që ne jemi sot këtu tregon edhe një herë vullnetin e Ministrisë së Drejtësisë për të pasqyruar sa më parë në ligj ato ndryshime kushtetuese dhe ligjore që janë të domosdoshme. Janë të domosdoshme po të kemi në konsideratë edhe periudhën tranzitore kur ka vepruar KLD-ja, e cila shpeshherë ka pasur vështirësi për aplikimin e masave disiplinore për shkak të paqartësisë që ka ekzistuar në kuadrin ligjor ekzistues lidhur me këto masa, të cilat ishin shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese.

Ministria e Drejtësisë edhe gjatë periudhës tranzitore ka qenë aktive në ngritjen e çështjeve ose në propozimin e masave disiplinore për gjyqtarë të caktuar, qoftë për periudhën tranzitore, qoftë edhe pas ngritjes së KLGJ-së dhe të KLP-së, duke vënë në dukje dhe duke theksuar nevojën për miratimin e këtyre ndryshimeve ligjore. Ne i përkrahim këto ndryshime dhe më pas do të komentojmë dispozitat, për të cilat kërkojmë ndoshta një rishikim, apo një riformulim të tyre.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Caka!

Zoti Dvorani, edhe ju në cilësinë e kreut të KED-së keni qenë pjesë aktive e grupit të punës në lidhje me nismat?

**Ardian Dvorani** - Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë jam këtu në cilësinë e kryetarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe, duke qenë e pjesë e grupit të punës, që ka punuar me të dyja nismat ligjvënëse, kemi arritur të nxjerrim produktin që keni përpara, si në ligjin për statusin e magjistratit, pra të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ashtu dhe në ligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Meqenëse jemi në diskutimin në parim, në projektligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” janë përfshirë edhe 2-3 amendamente, që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me organizimin dhe funksionimin e KED-së. Sikurse jeni në dijeni, këtë vit KED-ja jo vetëm që filloi të funksionojë normalisht, por tashmë është edhe në momentin kulmor të një sfide të pazakontë, që ka për të vlerësuar dhe për të verifikuar kandidatët për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese, inspektorët e lartë të drejtësisë dhe për të gjitha pozicionet. Por në kuadër të këtij procesi intensiv pune, Këshilli ka evidentuar disa çështje, të cilat janë të përfshira këtu, dhe për këtë ne jemi shumë të kënaqur, pasi meritojnë të trajtohen në mënyrë emergjente. Ka edhe disa çështje të tjera që përsëri ne i konsiderojmë emergjente, por që mund të presim derisa të fillojë sesioni i ardhshëm. Për këtë arsye ne kemi përgatitur një paketë të plotë normash me shtesa dhe ndryshime në dispozita të ndryshme të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, që, së pari synojnë të unifikojnë kriteret dhe kushtet ligjore të kandidimit, (më falni se po dal pak nga tema, por vetëm për një minutë!) që ndoshta kanë nevojë edhe për një ndryshim dhe shtesa në ligjin “Për Gjykatën Kushtetuese”, sepse vëmë re që ndonëse nuk kanë të bëjnë me natyrën specifike të pozicioneve në ligjet ku parashikohen kushtet dhe kriteret ligjore të kandidimit për gjyqtarët kushtetues dhe për inspektorët e lartë të drejtësisë, ka disa mangësi. Sigurisht që KED-ja ka ndërmarrë nismat e veta dhe i ka rregulluar me aktet nënligjore, por ne mendojmë që rregullimi i tyre në nivel ligji do të japë më shumë siguri



juridike dhe standarde edhe më të mira. E dyta, janë përfshirë disa norma që kanë të bëjnë me përbërjen e KED-it. Mënyra si janë formuluar dispozitat sot, ne mendojmë, prandaj dhe kemi propozuar këto nisma, se reduktojnë numrin e magjistratëve, të cilët mund dhe duhet të përfshihen në shortin për përzgjedhjen e anëtarëve të KEDësë, së dyti, përjashton në mënyrë jo të motivuar gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë. Për shembull, një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nuk mund të jetë anëtar i KED-së nëse nuk ka një vit që ushtron detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Pra, një gjyqtar kushtetues, i cili, pasi bën betimin, dhe të nesërmen mund të gjykojë një marrëveshje ndërkombëtare dhe çështjet më të rëndësishme të këtij vendi, nuk paska cilësitë për të qenë anëtar i një këshilli, i cili do të vlerësojë kandidatura për gjyqtarë? Ne mendojmë se janë disa kritere që nuk na duket se kanë arsye të ekzistojnë.

Këto janë ndryshimet që propozojmë.

Çfarë ndodh, duke ecur me këto lloj kriteresh, ose me kriterin që anëtari KED-së duhet të këtë përfunduar studimet për drejtësi? Normal që duhet t'i këtë përfunduar, sepse janë gjyqtarë dhe prokurorë, madje duhet të kenë përfunduar Shkollën e Magjistraturës. Nuk gjejmë asnjë arsye që gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët nuk kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës të mos jenë të përfshirë në garë, apo në shortin për të qenë anëtar të KED-së. E treta është për të garantuar funksionalitetin dhe përbërjen e plotë që kërkon Kushtetuta në KED.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Dvorani!

A është dakord Këshilli i Lartë Gjyqësor, që ka qenë pjesë e grupit të punës, në lidhje me dy nismat?

**Maksim Qoku** – Faleminderit, zoti kryetar!

Natyrisht që kemi qenë pjesë e grupit të punës, madje kemi qenë aktivë, sepse këto dy ligje i kemi pjesë të veprimtarisë thelbësore, pavarësisht disa ligjeve të tjera, që do të thotë se jemi dakord me projektligjin. Ne kemi punuar për këto ndryshime, sepse mbushin atë vakumin kryesor, që na ka penguar në aktivitetin tonë. Ndërkohë, pa dalë jashtë teme, sikurse bën zoti Dvorani, ne kemi akoma nevojë për ndryshime, ku pjesa më e madhe janë saktësime, pasi këtë na e tregon veprimtaria e përditshme në vendimmarrje, por duke e lënë për një kohë të dytë vazhdimin e punës së grupit të punës, ne falënderojmë për punën e kryer dhe për arritjen në këtë rezultat final, që do të japë mundësinë t'i japim një shtysë më tepër veprimtarisë sonë në vendimmarrje.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Qoku!

Fjalën e ka zonja Brenard nga misioni EURALIUS.

**Agnes Bernard** – Përshëndetje, i nderuar zoti kryetar!

Përshëndetje, të nderuar deputetë,

EURALIUS ka qenë pjesë e grupit të punës, ka ndjekur të gjitha punimet e zhvilluara dhe ne biem dakord me ndryshimet e reflektuara.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Bernard!

Kalojmë në pyetjet e kolegëve deputetë në lidhje me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”.

Kush ka pyetje?

**Adriatik Alimadhi** – Më falni, zoti kryetar, unë kam një pyetje për gjykatësin Dvorani në lidhje me pjesëmarrjen në dhënien e të drejtës për të përfaqësuar si në gjyqësor, ashtu dhe në prokurori të gjithë kontingjentin që ka mbaruar magjistraturën. A janë të dobishëm këta për ta kryer nga ana profesionale? Po fus këtu edhe pjesën e ndryshimit të legjislacionit.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Po, zoti Dvorani.

**Ardian Dvorani** – Nëse e kuptova drejt pyetjen, ishte fjala për magjistratët që kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës. Unë u përpoqa të isha sa më i koncentruar. Çështja është që sigurisht që ata mund ta bëjnë këtë detyrë si anëtarë të KED-së. Qasja dhe propozimi ynë është që nuk ka arsye që pjesa tjetër e gjyqtarëve të jenë të përjashtuar nga meritat (që prezumohet se i kanë), për të qenë anëtarë të KED-së për një arsye të thjeshtë: përderisa janë gjyqtarë apo prokurorë, të cilët janë në të njëjtat nivele, bëjnë të njëjtat gjykime, hetime, nuk ka arsye të mendohet se ata që kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës kanë disa cilësi të veçanta, që nuk i kanë gjyqtarët e tjerë. Kjo është arsyeja që propozohet kjo nismë, e cila sjell një rezultat tjetër, sepse mund të ndodhë, siç ka ndodhur në këto 2-3 vjet, që nuk ka as kandidatë për t’u shortuar më dhe KED-ja nuk arrin të plotësohet me 9 anëtarët që parashikon Kushtetuta. Kjo ka qenë dhe një nga arsyet pse KED-ja nuk mund t’i këtë 9 anëtarë në këtë moment dhe ndoshta kjo do të vazhdojë përsëri edhe vitin tjetër. Ne kemi funksionuar, sepse ligji e parashikon funksionimin edhe me më pak se 9 anëtarë, por do të ishte normale që Këshilli të përbëhej nga 9 anëtarë, siç e ka parashikuar Kushtetuta. Duke hequr kriteret që ne nuk mendojmë se kanë të bëjnë me ndonjë arsye të veçantë, unë jam i sigurt se KED-ja e ardhshme do të ketë përbërje të plotë.

Faleminderit, zoti Alimadhi!

Kush e do fjalën për pyetje?

Nëse nuk keni pyetje kalojmë në diskutime.

Po, zoti Lita.

**Korab Lita** – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar të ftuar,

Grupi Parlamentar Demokrat dhe shumica absolute e shqiptareve janë pro reformës në drejtësi, e cila, për hir të së vërtetës, është vonuar shumë në zbatimin e saj. Sot kemi për shqyrtim disa ndryshime të ligjit “Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve”, ndryshime që janë në zbatim të vendimeve të ish-Gjykatës Kushtetuese të vitit 2017. Në fakt, ne nuk e kuptojmë pse është vonuar kaq shumë reagimi ndaj vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Kjo është edhe si në formë pyetjeje. Duke i konsideruar si shumë të rëndësishme këto ndryshime, duke qenë shumë të ndjeshëm ndaj nevojës së krijimit dhe funksionimit sa më parë të strukturave ligjzbatuese të reformës në drejtësi, si dhe në akordancë të plotë me kërkesat e publikut ne si grup jemi pro miratimit të këtyre ndryshimeve ligjore. Uroj që këto ndryshime t’i shërbejnë sa më mirë zhbllokimit dhe funksionimit të këtyre strukturave me qëllim që implementimi i reformës në drejtësi të japë sa më parë efektin në publik.

**Ulsi Manja** - Faleminderit, zoti Lita!

Kush e do fjalën për diskutim përpara se të kalojmë në votimin në parim?

Ju lutem, relatore pak shkurt!

**Klotilda Bushka** - Zoti Lita keni shumë të drejtë për vonesën. Siç e tha edhe kryetari, ne e kemi filluar punën bashkë me misionin EURALIUS dhe me të gjitha palët në këtë proces që përpara një viti e gjysmë. Për shkak të bllokimit të Këshillit të Legjislacionit, për shkak të mungesës së ish-kolegëve të opozitës, bojkotit të gjatë të tyre dhe më pas djegien e mandateve, kjo punë ka mbetur pezull.

Në fakt, arsyeja pse ne nga momenti që zoti Fino, si kryetar i Këshillit për Legjislacionin ka mbledhur Këshillin për të punuar me këtë çështje dhe deri sot nuk kemi harxhuar më shumë se një muaj, tregon se ishte dashur një muaj që ky proces të bëhej dhe të plotësohej me dispozitat e nevojshme për zbatimin sa më shpejt të detyrimeve për reformën në drejtësi, të cilën e presin të gjithë shqiptarët. Prandaj unë sot i falënderova të gjithë për efektivitetin, për faktin se vullneti i maxhorancës dhe opozitës bëri që për 1 muaj t’i plotësonim ato mangësi të domosdoshme.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Kalojmë në votimin në parim. Kush është dakord me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”? Kundër? Një kundër. Abstenim? Asnjë abstenim.

Miratohet.

Zonja Bushka, ju lutem më ndiqni nen për nen, por edhe kolegët deputetë, si edhe të ftuarit.

Kalojmë në shqyrtimin dhe në miratimin nen për nen të këtij projektligji. Tabela i është bashkëngjitur relacionit. Ajo ka 3 kolona: ligjin në fuqi, projektligjin e ardhur në variantin e propozuar nga Këshilli i Legjislacionit dhe disa propozime për riformulime të ndryshme nga grupi i punës.

Ju lutem, shpjegimet përkatëse janë në secilën kolonë! Për efekt të kohës meqenëse është një variant i dakordësuar i grupit të punës, për të cilin u shprehën dakord të gjithë përfaqësuesit e institucioneve që kemi sot prezent, kemi edhe dakordësinë e kolegëve të opozitës, për të cilët gjej rastin t'i falënderoj për votën pro këtyre projektligjeve të rëndësishme.

Neni 1.

**Klotilda Bushka** - Ka vetëm riformulime teknike nga versioni i Këshillit të Legjislacionit.

**Ulsi Manja** – Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

**Klotilda Bushka** - Ka vetëm një saktësim të afatit të dakordësuar me grupin e punës. Bëhet fjalë për raportimin që bën magjistrati para këshillave, në rastin kur bën veprimtari të papaguara jashtë funksionit.

**Ulsi Manja** - Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3 i projektligjit.

**Klotilda Bushka** – Ky nen ka të bëjë me mungesat në detyrë të magjistratit. Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar një paragraf dhe është bërë riformulimi sipas arsytimit të Gjykatës Kushtetuese, ku është përcaktuar qartë se çfarë do të konsiderohet mungesë në detyrë dhe si vepohet në rastet e mungesave të pajustificuar në detyrë.

**Ulsi Manja** - Kush është dakord me nenin 3?

Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** - Zonja Bushka, çfarë do të thotë: “Ankimohet kur nuk vjen në punë brenda 7 ditëve”? Ti nuk vjen në punë, justifikon ditën e punës. Pastaj thua: “Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin e kryetarit të këshillit përkatës brenda 7 ditëve”. Çfarë do të ankimojë ai kur nuk vjen?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** - Nuk është ndryshuar, nuk është prekur.

**Klotilda Bushka** - Zoti Fino është në ligjin aktual, nuk e kemi prekur.

**Ulsi Manja** – Kush është dakord me nenin 3? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Neni 4.

**Klotilda Bushka** – Në nenin 4 kemi shtuar një shkak për uljen e ngarkesës së çështjeve dhe angazhimin e magjistratit, kur për çështje që lidhen me funksionin duhet të marrë pjesë në një detyrë. Për shembull, magjistratët mund të marrin pjesë në Këshillin për Emërimet në Drejtësi. Duhet t’iu ulet ngarkesa gjatë kohës që ata punojnë. Është një nen që është riparë si pasojë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, por edhe nga pikëpamja e formulimit.

**Ulsi Manja** – Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Kam një pyetje, por ndoshta do të më kthesh përsëri të njëjtë përgjigje: “ Nuk kemi mundësi ta ndryshojmë”, por më duket pak absurde kjo. “Arsyet e përkohshme personale ose familjare për një kohëzgjatje të kufizuar deri në 2 vjet|”. Pra, një magjistrat merr kohëzgjatje nga kryetari i tij 2 vjet kur ka një arsye personale dhe do të kthehet përsëri. Nuk e kuptoj këtë. Në asnjë institucion tjetër nuk e kam dëgjuar këtë gjë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Lindja 9 muaj është.

**Ulsi Manja** – Zonja Bushka, të marrim përgjigje për pyetjen e kolegut Fino?

**Klotilda Bushka** – Parashikimi është i drejtë në ligjin aktual. Është e drejtë e magjistratit. Në fakt grupi i punës në atë kohë kur ka punuar për paketën e ligjeve të reformës në drejtësi, i është referuar paketës së të drejtave, detyrimeve dhe standardeve ndërkombëtare, atyre më të mira që janë në kartën e gjyqtarëve. Kjo është një e drejtë, e cila thjesht është transpozuar nga standardet ndërkombëtare dhe është një e drejtë që i njihet magjistratit. Në momentin kur ka një sëmundje të përkohshme, pasi puna e gjyqtarit apo e prokurorit është një çështje, e cila kërkon qetësi dhe mirëqenie të shëndetshme të mendjes dhe të trupit. Pra, një sëmundje e përkohshme, e cila ndikon në profesionin e magjistratit, duhet të merret patjetër në konsideratë për uljen e ngarkesës, siç është këtu, deri në një periudhë prej 2 vjetësh. Pra, është i drejtë në ligj.

**Ulsi Manja** – Po, zoti Doshi.

**Tom Doshi** - Kam një pyetje. A e keni parashikuar që edhe burrat tani marrin leje lindje në Shqipëri?

**Ulsi Manja** - Po është parashikuar në momentin e bërjes së ligjit. Kush është dakord me nenin 4? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5 që ndërhyr te neni 64 i ligjit.

Pas nenit 4 ka një nen të ri, që lidhet me nenin 41.

**Klotilda Bushka** – Këtu, për afekt të qartësisht të afatit të ankimit në parashikimet e nenit 41 është shtuar një paragraf i ri. Neni bën fjalë për ankimimin që u bëhet vendimeve të këshillave, por në fakt nuk ka një afat. Kemi përcaktuar një afat 5 – ditor, duke iu referuar të gjithë afateve të ligjit në tërësi.

**Ulsi Manja** – Pra, është shtuar një nen i ri në nenin 41, pika 2, në fund të fjalisë së parë të shtohet shprehja me këtë përmbajtje: “Brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit të këshillit”. Pra, është disiplinuar një afat ankimi ndaj vendimeve të këshillit.

Kush është dakord me shtimin e këtij neni të ri, me këtë përmbajtje?

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet!

Po ashtu, shtohet një nen i ri për nenin 43, pika 7.

**Klotilda Bushka** – I vetmi ndryshim këtu, është një saktësim teknik. Bëhet fjala “këshillat”, sepse ka qenë në ligj “Këshilli i Lartë Gjyqësor”.

**Ulsi Manja** – Kush është dakord me shtimin e këtij neni të ri, me këtë përmbajtje?

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet!

Po ashtu, propozohet një nen i ri për nenin 44, pika 4.

**Klotilda Bushka** – E njëjta gjë si me nenin 41, për afatin e ankimit, shtohet afati i ankimit pesëditor.

**Ulsi Manja** – Këtu kemi një saktësim të afatit.

Kush është dakord me shtimin e këtij neni të ri, me këtë përmbajtje?

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet!

Kalojmë prapë te një nen i ri, i cili ndryshon nenin 48.

Edhe neni 48 është saktësim i terminologjisë ligjore.

Kush është pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet!

Kalojmë te neni 5, që ndryshon nenin 64. Nuk ka propozime nga Këshilli i Legjislacionit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, për nenin 5.

**Adriatik Alimadhi** – Te pika 5: “Statusi i magjistratit...”

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem!

**Adriatik Alimadhi** – “Statusi i magjistratit mbaron në fund të muajit, në të cilin magjistrati mbush moshën 67 vjeç”.

Pra, këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë. A mos është pak kjo? Sepse në proces, një gjyqtar mund të ketë ngarkesë. Pra, të njoftohet pak më parë. Kështu mendoj unë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem, një përgjigje për zotin Alimadhi.

**Klotilda Bushka** – Këto janë çështje, të cilat rregullohen me akte të këshillave, qoftë të gjyqësorit, qoftë të prokurorisë, kur bëhet fjalë për daljen e një magjistrati në pension. Në rastin konkret, ne nuk flasim për momentin si do të rregullohen çështjet që janë pezull, kur të dalë, sepse sipas rregullave që kanë të dy këshillat, ato do të jenë rregulluar që më parë. Kjo ka të bëjë me pasjen e një date fikse, të përcaktuar, se kur do të konsiderohet i mbaruar mandati, nga ku lindin një sërë të drejtash për magjistratin, që të dalë në pension.

**Ulsi Manja** – Po, zoti Alimadhi.

**Adriatik Alimadhi** – Unë gjithmonë mendoj, duke pasur parasysh procesin që ndjek një gjyqtar, se e lë në mes pjesën e procedurës në mes. T’i japësh dy javë kohë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem!

Po, zoti Fino!

**Bashkim Fino** – Ai nuk e merr vesh dy javët e fundit, se kur mbush 67 vjeç. Ai e di se kur i mbush 67 vjeç. Është tjetër gjë dyjavëshi i fundit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kush është dakord me nenin 5?

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet!

Ka një nen të ri te neni 70, pika 3. Fjalja e dytë ndryshohet si më poshtë, ku ka një saktësim ligjor: “Këshillat miratojnë rregulla të detajuara për vlerësimin e magjistratëve në skemën e delegimit ose të kombinuar”.

Kush është dakord me shtimin e këtij neni të ri?

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Kalojmë te neni 6.

Zonja Bushka.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk ka ndryshime neni 6.

Kush është pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Ka përsëri një nen të ri në fjalinë e dytë të pikës 1 të nenit 85. Fjala “pasardhës” zëvendësohet me fjalën “përkatës”, pra kemi saktësim termi.

Kush është pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Sërish ka një nen të ri te neni 91, pika 4. Pas fjalës “vendim” shtohet fjala “jopërfundimtar”.

Kush është pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Kalojmë te neni 7.

**Klotilda Bushka** – Në nenin 7 është bërë vetëm një rregullim. Në kuadër të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, është hequr fjala “vlerësim më i ulët”, sepse më parë, togfjalëshi i referohej vlerësimit më të ulët, dhe s'kishte vlerësim më të ulët se ai. Kudo në nen, “vlerësim më i ulët se i mëparshmi” është hequr, sepse i referohet në mënyrë specifike vlerësimit të pamjaftueshëm. Është saktësuar edhe çështja e afatit të ankimit, edhe gjykata kompetente ku bëhen ankimet.

**Ulsi Manja** – Në rregull!

Kush është dakord me nenin 7?

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet neni 7!

Ka një nen të ri, që pika 6 e nenit 97 ndryshohet me këtë përmbajtje: “magjistrati ka të drejtën e ankimit”. Pra, është saktësuar afati i ankimit, nga momenti i njoftimit të vendimit.

Kush është dakord me shtimin e këtij neni të ri?

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Kalojmë te neni 8, që i referohet nenit 101 të ligjit.



**Klotilda Bushka** – Neni 8 është komplet, le të themi, dispozita e shkeljeve disiplinore, që u shfuqizua me vendim të Gjykatës Kushtetuese. Është riformuluar nga e para.

**Ulsi Manja** – Kush është dakord me nenin 8?

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Kalojmë te neni 9. Edhe neni 9 i referohet kapitullit të masave disiplinore.

Kush është pro?

**Adriatik Alimadhi** – A mundem, zoti kryetar?

**Ulsi Manja** – Po, zoti Alimadhi ka pyetje për neni 9.

**Adriatik Alimadhi** – Në fakt, e kam thënë edhe një herë tjetër, për një projektligj tjetër që kemi kaluar; unë e shoh se neni 9 ka të bëjë me ndryshimet e nenit 102: “Shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit”. Në fakt, është e ngarkuar shumë. Kjo më duket më shumë si rregullore, se si nen ligji.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Pra, rregullimi i nenit 9, që prek neni 102, është një rregullim motamo siç ka urdhëruar Gjykata Kushtetuese.

Kush është dakord me neni 9?

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Kalojmë te neni 10, që prek neni 103. Edhe ky nen u referohet shkeljeve disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit, edhe ky urdhërim i Gjykatës Kushtetuese.

Kush është pro neni 10?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ka pyetje?

**Adriatik Alimadhi** – Jemi te neni 10, që ka të bëjë me ndryshimet e nenit 103: “Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit, pranimit dhe ushtrimit të detyrave dhe veprimtarive jashtë funksionit pa leje nga këshilli, shoqërimi me persona që janë në ndjekje penale ose që janë subjekt i procedimit penal...”

Ka ngarkesë. A nuk e shikoni?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ka ngarkesë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mua më kujtohet koha kur ndokush rrinte me mua para viteve 90; jo që cilësohej armik, por konsiderohej i dekluar dhe futej në listën e zezë. Mendoj se kjo ka ngarkesë, dhe nuk e

ka të specifikuar se çfarë kategorie futet aty. Unë po e shoh se ju po e bëni: “Ka pro? Ka kundër? Kalo!”

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është dakordësuar, por mbase edhe ndonjë eksperiencë e jona i vlen këtij komisioni.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Neni 10, që ndryshon nenin 103: “Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit”.

Edhe ky nen është reflektim i urdhërimeve të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Kush është pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet!

Kalojmë te neni 11, që ndryshon nenin 104: “Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale”.

Është e njëjta linjë.

Kush është pro neni 11?

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet!

Ka një nen të ri në nenin 126, pika 5, fjala “procedimit” zëvendësohet me fjalën “parashkrimin”. Është ndërhyrje teknike.

Kush është pro shtimit të këtij neni?

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet!

Kalojmë te neni 12. Edhe këtu kemi të bëjmë me ndryshime të natyrës së teknikës legjislativë, në funksion të qartësisë së normës.

Kush është pro neni 12?

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet!

Kalojmë te neni 13, që i referohet neni 152 të projektligjit. Edhe këtu ka rregullime të natyrës së teknikës legjislativë dhe saktësisë të terminologjisë ligjore.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sigurisht, sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Kush është pro neni 13? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet!

Kalojmë te neni 14, që saktëson nenin 153 të ligjit. Nuk ka ndryshime. Kush është pro neni 14? Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet!

Kalojmë te neni 15, që ndryshon nenin 156.

**Ulsi Manja** – Po, zonja Bushka.

**Klotilda Bushka-** Është bërë vetëm një ndryshim, sepse ky nen është prekur me vendim të Gjykatës Kushtetuese. Nga versioni që ka miratuar Këshilli i Legjislacionit është saktësuar se në cilat referenca ne do të çojmë përmbajtjen e nenit përkatës.

**Ulsi Manja** – Kush është dakord me nenin 15? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kemi një nen të ri, është një dispozitë kalimtare, zonja Bushka, ju lutem një shpjegim!

**Klotilda Bushka-** Në grupin e punës u diskutuan shumë çështje, të cilat kanë bllokuar funksionimin e një sërë pasojash që ne prisnim nga reforma në drejtësi, njëra prej tyre është edhe emërimi i atyre që mbarojnë Shkollën e Magjistraturës dhe presin të emërohen në detyra të reja. Konkretisht, brezi i magjistraturës i vitit 2018, por edhe ai brez që do të mbarojë në vitin 2019 nuk do të emërohet dot, emërimi i tyre është prioritet, por në nenin 39 ky prioritet duket sikur pengohet nga një paragraf më sipër, i cili e lidh emërimin e këtyre magjistratëve me procedurën e ngritjes në detyrë apo lëvizjes paralele të magjistratëve të emëruar. Ndërkohë, edhe vetë lëvizja në detyrë e magjistratëve të emëruar, apo lëvizja paralele është e varur nga vlerësimi etik profesional i tyre. Lidhur me vërshimin etik profesional të tyre është e nevojshme të bëhen disa akte nënligjore, rregullore, të cilat nuk janë bërë ende dhe janë në proces për t'u bërë, sepse duhet të kini parasysh të gjitha vonesat për ngritjen e institucioneve, ku tre janë të drejtësisë, të cilat kanë shtyrë në kohë edhe miratimin e këtyre akteve. Nga ana tjetër, edhe vlerësimi etik dhe profesional i atyre që janë në detyrë, me efekt lëvizje paralele apo ngritje në detyrë, do të marrë kohën e vet, kështu që magjistratët e vitit 2018 janë ende të paemëruar, ata që kanë mbaruar shkollën, dhe ata të vitit 2019 do të kenë të njëjtin fat, ndërkohë që ne sot kemi nevoja të ngutshme që në gjykata dhe prokurori të plotësohen vakancat e krijuara nga vetingu. I gjithë grupi i punës, së bashku me EURALIUS-in, edhe në kuadër të lehtësimit të vendimit të grupit të punës, ka arritur të formulojë këtë gjë dhe të gjithë kanë rënë dakord.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Pse duhet të bëjmë një dispozitë kalimtare për një rregullim të përgjithshëm kur ne mund ta lidhim vetëm me këta që kemi emergjencën, me vitet 2018-2019, që pengohet për shkak të kësaj? Nuk kemi arsye, sepse do të vazhdojë normaliteti. Unë nuk e kuptoj dot pse nuk e ka bërë këtë gjë deri tani?! Në qoftë se Këshillit i është dashur të miratojë akte nënligjore të vlerësimit etik dhe profesional, ai ka 6 muaj në detyrë dhe duhet ta kishte përfunduar, sepse Këshilli nuk është KLD-ja e mëparshme dhe këtë duhet ta ketë qartë edhe KLGJ-ja, edhe KLP-ja. Çfarë do të thotë që nuk është KLD-ja e mëparshme?! Do të thotë që

nuk është *part time*, por *full time* për këtë arsye, për të funksionuar si një qeveri e gjyqësorit, permanente dhe në aktivitet aktiv gjatë gjithë periudhës dhe jo për të punuar *part time* me orare të kufizuar në periudha të kësaj natyre.

**Ulsi Manja**- Faleminderit, zoti Xhafaj!

Zoti Toska, pse ka lindur kjo nevojë?

**Ilir Toska**- Atëherë, sipas ligjit, Këshilli duhet të miratojë disa akte rregullatore në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional. Aktet janë draftuar dhe jemi në fazën finale të miratimit të tyre. Nga ana tjetër, zbatimi i këtyre do të marrë përsëri disa muaj të tjerë kohë.

**Fatmir Xhafaj**- Pse?

**Ilir Toska**- Sepse sipas ligjit kërkohen disa procedura, ku secila kërkon kohën e nevojshme për të finalizuar një vendim për secilin nga gjyqtarët e Republikës.

**Ulsi Manja**- Në variantin që propozohet, ky nen i ri u referohet magjistratëve të viteve 2018-2019. A është e nevojshme ta kufizojmë vetëm për këtë kategori magjistratësh, zoti Toska, apo ta lëmë ashtu si është formuluar në variantin që kemi në tavolinë? Kjo nuk do të thotë që ju të mos e shpejtoni punën për miratimin e kuadrit nënligjor.

**Ilir Toska**- Kuadri nënligjor është në fazën finale, të cilin do ta miratojmë, por çështja ka të bëjë me zbatimin e tij në praktikë, që do të duhet edhe disa muaj të tjerë, prandaj është bërë emergjente kjo gjë.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Sa zgjat për Këshillin kjo periudhë tranzitore? Kjo është për magjistratët e viteve 2018-2019, apo është për disa breza, duke llogaritur se vitin që vjen ju nuk keni se çfarë të miratoni?

**Ilir Toska**- Për magjistratët që janë diplomuar në vitet 2018-2019 kjo është bërë tashmë shumë urgjente, sepse duhet t'i miratojmë. Në dispozitën që keni përpara nuk është vënë një afat kohor që të përcaktojë edhe këto dy kategori, por mund të përfshihet ajo e vitit pasardhës.

**Ulsi Manja** – Kush është dakord me nenin e ri, dispozitë kalimtare, sipas variantit të grupit të punës? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 16 i ligjit “Hyrja në fuqi”. Nuk propozohen ndryshim për këtë nen. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Një kundër. Abstenim nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016  
"Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.07.2019, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Korab Lita, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Alket Hyseni, Edmond Leka, Bashkim Fino, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Alban Zeneli, Adriatik Alimadhi, Elena Xhina, Andi Përmeti, Elda Hoti, Aurora Mara, Ediola Braha dhe Tom Doshi.

#### **Mungojnë:**

Vasilika Hysi dhe Damian Gjikhuri

#### **Të ftuar**

Fjoralba Caka – Zëvendësministre e Drejtësisë

Ardian Dvorani – Kryetari i KED-së

Maksim Qoku – Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor

Illir Toska – anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor

Agnes Bernard – drejtuese e misionit EURALIUS.

**Ulsi Manja**- Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Edhe për këtë projektligj e kemi tabelën mbi tavolinë. Ju lutem zonja Bushka, më ndiqni me këtë projektligj në mënyrë kronologjike sipas neneve!

Neni 1.

**Klotilda Bushka**- Versioni që është miratuar në Këshillin e Legjislacionit ka thjesht formulime teknike për efekt qartësie dispozite.

**Ulsi Manja** - Më falni, sepse kaluam në shqyrtimin nen për nen pa e votuar në parim.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”? Kundër? Një kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 2, ku është e njëjta logjikë e reflektimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Kush është pro neni 2? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Pas neni 2 kemi një nen të ri, në nenin 6, pika 4, pas fjalëve “vendos në bazë” shtohen fjalët “të këtij ligji”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 3, i cili ndryshon nenin 61, “Mbledhja plenare e Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 4, i cili ndryshon pikën 2 të neni 76. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Pas neni 4 ka një nen të ri, në nenin 100, në pikën 1, fjalia e parë ndryshohet me këtë përmbajtje, edhe këtu shtohet një afat ankimi ndaj vendimeve të këshillit dhe është përcaktuar edhe gjykata kompetente e ankimit, që është Gjykata Administrative e Apelit. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 5, i cili ndryshon nenin 103, “Shkeljet disiplinore të anëtarëve të Këshillit”. Është njëlloj si ata që miratuam për KLGJ-në. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 6. Është i njëjti reflektim lidhur me shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Pas nenit 6 kemi një nen të ri. Në nenin 104, në pikën 4, pas fjalëve “vendos në bazë” shtohen fjalët “të këtij ligji”; është saktësim terminologjie ligjore.

Kush është dakord me nenin e ri? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Përsëri kemi një nen të ri. Në nenin 157 të ligjit, pika 3, germa “dh” fjalët: “sistemi gjyqësor’ zëvendësohen me fjalën “prokurori”, pra janë rregullime të teknikës ligjore.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 7, që ndryshon nenin 159 “Mbledhja plenare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 8, paragrafi i dytë i nenit 175 ndryshohet si më poshtë: E kemi formulimin.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Pas nenit 8, kemi 4 nene të reja. Neni i ri në nenin 192, në pikën 1, fjalia e parë ndryshohet me këtë përmbajtje: edhe këtu kemi afatin ligjor të ankimit dhe gjykatën kompetente për ankimin.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kemi një nen të ri, në nenin 220, në fund të pikës 8 shtohen fjalët: “Sipas rregullave të përcaktuara në aktet e këshillit”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Më pas te neni 221 kemi një ndryshim.

Urdhëroni, zonja Bushka!



**Klotilda Bushka** – Përveç ndryshimit që keni në tabelë, nga konsultimi i fundit, në germën “dh”: “magjistrati që ushtron funksion...”, pra do të ngelet siç është germa “dh” e nenit aktual, vetëm do të shtohet paragrafi “kur është e mundur”. Jo sipas formulimit që keni, por vetëm do të shtohet në nenin aktual shprehja “kur është e mundur”.

**Ulsi Manja** - Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Më pas kemi një nen të ri, në nenin 225, pika 1, nenet 133 dhe 134 ndryshohen dhe bëhen 222, 223 dhe 224.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9 “Hyrja në fuqi e ligjit”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është dakord me votimin në tërësi me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”? Kundër? 1 kundër Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji.

Këtu i mbyllim dy projektligjet, që kishin të bënin me reflektimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nr. 34, 41 dhe 78 të vitit 2017 në dy ligje shumë të rëndësishme të reformës në drejtësi.

Zonja Bushka, si relatores e bëri falënderimin, kurse unë dua të falënderoj kolegët e mi deputetë, kolegët e opozitës për qasjen konstruktive ndaj këtyre ligjeve të reformës në drejtësi, grupin e punës, përfaqësuesit e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Ministrinë e Drejtësisë për përfshirjen aktive në miratimin e këtyre ndryshimeve dhe në mënyrë të veçantë misionin EURALIUS, që ka qenë bashkëpunëtori ynë i përhershëm që nga dita e parë e nisjes së reformës në drejtësi dhe do të vazhdojë të jetë me ne për një kohë të gjatë deri kur ta implementojmë plotësisht reformën në sistemin e drejtësisë!

Gjithashtu, dua të falënderoj mediet për pasqyrimin e kësaj mbledhjeje të komisionit, siç i ka pasqyruar në dinamikë të gjitha çështjet e reformës në drejtësi; mediet vazhdojnë të jenë zëdhënëset e denja të opinionit publik për sa i përket zbatimit të reformës në drejtësi!

Dua të falënderoj të ftuarit e këtyre dy projektligjeve të para, për të kaluar në pikën e tretë dhe të fundit të rendit të ditës: zonjën Caka, zotin Dvorani, zotin Qoku, zotin Toska dhe zonjën Bernard!

Faleminderit për prezencën në komision!

Ditë të mbarë dhe javë të mbarë!

Ngelemi të hapur për bashkëpunim të mëtejshëm, për sa u përket ndryshimeve të tjera të reformës në drejtësi, që do t'i diktojë nevoja e zbatimit në praktikë të këtyre ligjeve.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.07.2019, ora 12:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për mbrojtjen civile”.

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Korab Lita, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Alket Hyseni, Edmond Leka, Bashkim Fino, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Alban Zeneli, Adriatik Alimadhi, Elena Xhina, Andi Përmeti, Elda Hoti, Aurora Mara, Ediola Braha dhe Tom Doshi.

#### **Mungojnë:**

Vasilika Hysi dhe Damian Gjikhuri

#### **Të ftuar**

Petro Koçi - Zëvendësministër i Mbrojtjes

Haki Çako - Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile (DPEC)

Ismail Shehu - Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standartizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore në Ministrinë e Mbrojtjes

Maksimiljan Dhima - Drejtor i Planifikimit dhe Koordinimit pranë DPEC-së

**Ulsi Manja** – Kalojmë te pika e tretë e rendit të ditës: shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për mbrojtjen civile”.

Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi, pasi komision përgjegjës është Komisioni për Sigurinë Kombëtare. Relator është kolegu Edmond Leka. Nuk e di nëse janë paraqitur përfaqësuesit Ministrisë së Mbrojtjes.

*(Mungesë regjistrimi)*

Mendoj që këtë pikë të rendit të ditës, duke qenë se kemi edhe mbledhjen e posaçme të komisionit hetimor në orën 13:00, ta shtyjmë për mbledhjen e ardhshme.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E kemi votuar në parim, jemi në fazën e shqyrtimit dhe miratimit nen për nen.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Urdhëroni, zoti Leka!

**Edmond Leka** – Në fakt, janë shumë nene dhe nuk besoj se i mbyllim dot nesër. Të kalojmë sot disa nene derisa të shkojë ora.

**Ulsi Manja** – Atëherë, vazhdojmë me nenet e para të këtij projektligji, por në orën 12:45 mbledhja do të mbyllet.

Ju lutem, zoti Leka, më ndiqni!

Këtë projektligj e kemi kaluar një parim, jemi te neni 1 i projektligjit.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Përfaqësuesi i Ministrisë së Mbrojtjes, zoti Shehu, kur ta shikoni të nevojshme, mund të ndërhyri.

Urdhëroni, zoti Leka!

**Edmond Leka** – Në këtë projektligj është e nevojshme të bëhet një redaktim i teknikës legjislative për shkak të përshtatjes që kemi me direktivat europiane, sepse është vënë re përdorimi i termave apo i formave që nuk janë të përshtatshme për dispozitat ligjore. Kështu që duhet të bëhet një redaktimi i gjithë ligjit.

**Ulsi Manja** - Urdhëroni, zoti Shehu!

**Ismail Shehu** – Javën e kaluar ishim te Komisioni i Integritit Europian, ku u bënë komente pikërisht për këtë çështje dhe janë redaktuar të gjitha është bërë rakordimi me Komisionin e Integritit Europian; janë përshtatur çështjet e emërimit të direktivave dhe terminologjia. Pra, është bashkëngjitur.

**Ulsi Manja** - Faleminderit, zoti Shehu!

Në fakt, kemi rënë dakord edhe në ndryshimet, që i bëmë Rregullores së Kuvendit që për çështjet e përafrimit të legjislacionit me BE-në primar do të jetë mendimi i Komisionit të Integritetit Europian. Komisioni ynë, si komision për dhënie, do të shprehet për këtë projektligj për bazën kushtetuese dhe qasjen me kuadrin ligjor, që kemi në fuqi. Për këtë jemi komision për dhënie mendimi. Gjithsesi, sugjerimi i kolegut Leka ishte i duhuri.

Kalojmë te neni 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3 “Përkufizimet”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5 “Parimet”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7.

Urdhëroni zoti Fino!

**Bashkim Fino** – Te neni, që ka të bëjë me parimin e subsidiaritetit, pra me organet e pushtetit vendor, nuk më pëlqen që fjalia të jetë e formuluar kështu: “Nëse kapacitetet e njësisë së qeverisjes vendore të jenë të pamjaftueshme.” Absolutisht, kur ka një fatkeqësi natyrore apo një fatkeqësi tjetër dhe kërkohet mbrojtja, shpëtimi dhe ndihma, fillimisht përdoren kapacitetet e njësisë së qeverisjes vendore. Kjo është e vërtetë, por nuk mund të themi: “Nëse kapacitetet e njësisë së qeverisjes vendore të jenë të pamjaftueshme, atëherë dërgohen këto nga ju”. Kjo është një ndërthurje e pushtetit vendor me atë qendror, natyrisht në funksion të fatkeqësisë apo të dëmeve që ndodhin. Domethënë, kur ka një dëm të vogël, natyrisht që i pari shkon në ndihmë organi i pushtetit vendor, por, kur fatkeqësia është e një përmase më të madhe, duhet të ndërhyri ju si ministri, sepse ligji bëhet për ju dhe jo për pushtetin vendor.

Unë jam dakord me nenin 7, por duhet riformuluar. Aty thuhet: “Nëse janë kapacitet...”. Çfarë do të thotë kjo? Ajo vlerësohet nga fatkeqësia që ndodh.

**Ulsi Manja** – Zoti Shehu, sugjerimi i kolegut Fino ka të bëjë edhe me përdorimin e shpeshtë të terminologjisë “nëse, nëse, nëse” ndoshta duhet të gjendet formulimi i duhur.

**Bashkim Fino** – Ministria e Mbrojtjes mund të thotë: “Jo, nuk vijmë, sepse ju i keni kapacitetet, por nuk doni ta bëni”, ndërkohë që pushteti vendor nuk i ka mundësitë ta bëjë.

Kur fatkeqësia ndodh, prioritet është mbrojtja e qytetarit, kjo do të thotë se mbrojtja e qytetarit duhet të bëhet me çdo formë. Ndihma e parë duhet të jetë nga organet e pushtetit vendor, por, nëse nuk kanë mundësi, urgjent të shkojë ushtria, në mënyrë që të mos thuhet: “Vazhdoni ju se i keni kapacitetet”, sepse këtë nënkupton ky nen. Formuloheni më saktë që të dihen detyrat e secilit organ.

**Ulsi Manja** – Po, zoti Shehu.

**Ismail Shehu** – Parimi i substencialitetit ka këtë shpjegim, pra ndërhyrjen hap pas hapi sipas nevojës. Megjithatë, në nenet në vijim, te pjesa e kategorizimit të emergjencave civile, del shumë e qartë, që pavarësisht kategorizimit, AKMC-ja ka të drejtë të ndërhyjë në çdo moment edhe nëse emergjenca vendore është e lokalizuar. Pra, kjo nuk i pengon në asnjë moment as Agjencinë, as Forcat e Armatosura, as policinë dhe çdo institucion tjetër që ka kompetenca operacionale të ndërhyjë në çdo rast, në mënyrë që situata të mos përshkallëzohet. Kjo është çështje parimore që bëhet shkallë–shkallë, por ndërhyrja nga lart është e legjitimuar në nenet e tjera të këtij ligji dhe nuk pengohet në asnjë moment.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Shehu!

Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Unë mendoj se duhet riformuluar, sepse, po ta shikojmë me vëmendje, janë tri pika. Pika e parë u jep mundësi organeve të pushtetit vendor të veprojnë.

Në pikën e dytë, me ligj u thuhet se, nëse nuk ke mundësi dhe kapacitete, kërko ndihmë nga bashkia më e afërt dhe të ndihmon ajo.

Në pikën e tretë thuhet: “Nëse përsëri nuk ke mundësi dhe kapacitete, do të ndërhyjmë ne sipas ligjit dhe akteve të tjera ligjore që kemi miratuar”. A e kuptoni se çfarë është shkruar? Mua më duket sallatë dhe duhet rregulluar me patjetër.

**Ulsi Manja** – Zoti Fino, a mund ta lëmë të hapur nenin 7 dhe kur të shikojmë te neni 31, të shikojmë mundësinë për ta rregulluar me këtë nen dhe, ta votojmë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nenin 7 e lëmë të hapur dhe kur të shikojmë te neni 31 mund të shikojmë se si harmonizohet me nenin 31.

Kalojmë te kreu i II-të “Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë”, i cili fillon me nenin 8.

Neni 8.

Kush është pro me nenin 8? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9, “Vlerësimi i Riskut”

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10, “Strategjia kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11.

Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Unë kam vërejtje për këtë nen, sepse një organ i qeverisjes vendore zgjidhet një herë në katër vjet dhe nuk ka mundësi që njësitë e qeverisjes vendore, me vendim të këshillit bashkiak, miraton çdo 5 vjet strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, kjo e harmonizuar me strategjinë kombëtare të zvogëlimit të riskut... Kjo mua më duket e pa konceptueshme.

Ne duhet të bëjmë ligje që të zbatohen, por jo t’u themi bashkive: bëni një strategji kot atje, sepse ti nuk ke mandat 5-vjeçar, por t’i bëje për 5 vjet. Këshilli dhe kryetari i bashkisë, në momentin që janë zgjedhur, puna e parë që duhet të bëjnë është strategjia për zvogëlimin e riskut për katër vjet. Çfarë lidhje ka për 5 vjet? Pas 5 vjetëve mundet që të mos jetë ai kryetar dhe ai këshill bashkiak dhe strategjia e kryetarit të mëparshëm duhet të vazhdojë edhe me kryetarin e ri?

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Zoti Shehu, cila ka qenë logjika e propozimit dhe mospërputhja me mandatin?

**Ismail Shehu** – Pavarësisht se duket si dokument politik, ky dokument është i pastër teknik, është strategji për zvogëlimin e riskut. Pra, janë elemente teknike shkencore që pushteti vendor merr masa për të eliminuar risqet potenciale që vijnë nga dora e njeriut apo shkaqe natyrore dhe nuk ka të bëjë fare me zgjatjen e mandatit të një këshilli apo kryetari bashkiak.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ne si komision për dhënie mendimi mbështesim mendimin e kolegut Fino dhe sugjerojmë që afati 5 vjet të përputhet me mandatin e këshillave dhe kryetarëve të bashkive.

Kush është dakord me nenin 11 dhe me sugjerimin për ndryshimin e afatit, pra nga 5 të bëhet 4 vjet? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12, “Harmonizimi i planeve të zhvillimit urban, me strategjitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë”

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13, “Vërtetimi i riskut”.

Po, zoti Leka.

**Edmond Leka** – Unë mendoj që pika 2 “Vërtetimi mbi riskun” të kalojë te pika 1, kjo për qartësi të dispozitës, sepse duhet të qartësohet se çfarë është vërtetimi mbi riskun dhe pastaj të themi: “Përpara pajisjes nga organet kompetente”.

**Ulsi Manja** – Jemi dakord me sugjerimin

**Edmond Leka** – Zoti kryetar, edhe te pika 6 të cilësohet që ankimimi të bëhet në Gjykatën Administrative brenda 30 ditëve.

**Ulsi Manja** – Po, zonja Xhina.

**Elena Xhina** – Faleminderit, zoti kryetar!

Në vijim të asaj që theksoi kolegu, pika 2 nuk na sqaron se çfarë është “vërtetimi mbi riskun”, prandaj sugjeroj që te termi “përkufizime”, të përkufizohet se çfarë do të thotë “vërtetim mbi riskun”. Pra, pavarësisht ndërrimit të vendeve, nga pika 2 te pika 1, përsëri nuk është e qartë se çfarë do të thotë “vërtetim mbi riskun”.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Xhina!

Po, zoti Shehu.

**Ismail Shehu** – Jemi dakord me rinumërimin e pikave të nenit dhe me shtimin e një pike për përkufizime, nuk ka asnjë problem.

**Ulsi Manja** – Te neni i përkufizimeve flitet për vlerësimin e riskut, për riskun dhe për të gjitha, nëse është nevojshme që të qartësohet se çfarë do të thotë “vërtetim risku” ne jemi dakord. Këshilltarët dhe relatorët, kur të zbardhin projektligjin dhe raportin, të kujdesen edhe për qartësimin e pikës 2.

Kush është dakord me nenin 13, me sugjerimet e bëra nga relatori dhe zonja Xhina? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14, “Planet për emergjencat civile”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu i III-të “Sistemi i mbrojtjes civile”, i cili fillon me nenin 15.

Neni 15, “Sistemi i mbrojtjes civile”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te seksioni 1, “Institucionet dhe strukturat qendrore të mbrojtjes civile”.



Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Unë kam vërejtje për këtë nen, sepse më duket shumë burokratik. Shikoni se çfarë bëjnë këta, i fusin 9 shkallë duke filluar nga Kuvendi, Këshilli i Ministrave, Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile, pastaj me Komitetin e Mbrojtjes Civile, me ministrin përgjegjës të Mbrojtjes Civile, me ministrat e institucioneve qendrore, pastaj me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, pastaj me Komisionet e Teknikës Këshillimore dhe deri te Qendra e Mbrojtjes Civile në qark. Pra janë gjithë këto hallka. Mbase këta të Ministrisë së Mbrojtjes janë mësuar dhe i zbatojnë, por në praktikë pushteti vendor i quan të tepërta...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kjo shkallë mua më duket shumë burokratike dhe e zgjeruar. Për të marrë një vendim dhe për të arritur në pikën e ndërhyrjes, gjithë këto shkallë mua më duken burokraci për njëra-tjetrën.

Kur thoni: “Këshilli i Ministrave” e ke nënkuptuar Komitetin Ndërministror të Emergjencave, sepse Këshilli i Ministrave mund ta vendosë që 1, 2, 3, 4 ministra do të jenë në Komitetin Ndërministror të Emergjencave, dhe ju e shtoni si shkallë.

Kur thoni: “Komiteti i Mbrojtjes Civile dhe zyrat përgjegjëse të situatës”, nuk e di se çfarë duhet Qendra e Mbrojtjes Civile në çdo qark, kur ne do ta bëjmë në çdo bashki. Pra e bëjmë në çdo bashki, e bëjmë kombëtare dhe në çdo qark, por ndërkohë ata ia lënë “topin” njëra-tjetrës, sepse kur ka ndonjë fatkeqësi, për të bërë një faturë, sepse aty është te fatura për ndihmën e menjëhershme, pushteti vendor sorollatet kaq shumë për të marrë frytet e financës. Nëse kjo është bërë pikërisht për këtë gjë, atëherë është e gabuar.

Unë mendoj se kemi dy nivele, nivelin e pushtetit vendor, ku janë 61 bashki me ndarjen e re territoriale, pra do të kemi 61 Qendra të Mbështetjes Civile dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, e cila është në Ministrinë e Mbrojtjes. Të gjitha këto shkallë krijojnë anomali. Për shembull, pushteti vendor bën dokumentin, të cilin e shikon bashkia, pastaj e merr qarku, pastaj qarku e çon te Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, pastaj shkon te Komiteti, pastaj te ndërministrorët, të cilët thonë se do të paguajmë këtë faturë.

Unë e di se si ndodh në praktikë, prandaj po them se të gjitha këto shkallë janë burokraci.

**Ulsi Manja** – Po, zoti Shehu.

**Ismail Shehu** – Të gjitha ato shkallë janë ekzistuese dhe nuk ka asgjë të re, përveç riformulimit. Ky është një ligj kuadër, i cili i ka të strukturuar në mënyrë ezauruese të gjitha institucionet dhe entet që kanë kompetenca në fushën e mbrojtjes civile dhe janë listuar nga e para tek e fundit.

Fakti që është i shkallëzuar nuk do të thotë se për të vepruar, ndërhyrë, kompensuar e të tjerë do të kalohet në të gjitha këto shkallë. Jo, sepse secila prej tyre ka detyrat e veta në fusha të caktuara të mbrojtjes civile.

**Ulsi Manja** – Unë kam një pyetje. Në vazhdim të shqetësimit të kolegut Fino, kur bëjmë përkufizime institucionesh, kjo listë është shteruese, apo lind nevoja të shtoni edhe institucione të tjera?

**Ismail Shehu** – Është shteruese, është menduar. Janë marrë modele të huaja.

**Ulsi Manja** – Pra, është shteruese.

**Person** – Është shteruese dhe nuk ka asgjë shtesë.

**Ulsi Manja** – Nesër mund t'ju lindë nevoja të shtoni edhe diçka tjetër.

**Person** – Jo.

**Ulsi Manja** – Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Kam një pyetje, nisur edhe nga praktika ime, pasi kam qenë kryetar bashkie dhe ministër i Pushtetit Vendor: për çfarë shërben Qendra e Mbrojtjes Civile në qark? Fakti që nuk duhet, nuk është e nevojshme, duket. Po e lexoj se ku duket, sepse është e detajuar në neni 26 “Qendra e Mbrojtjes Civile në qark” ku thuhet:

1. “Qendrat e Mbrojtjes Civile në qark janë struktura në varësi të qarkut, me seli në çdo qark dhe përbëjnë rrjetin institucional, sinjalizues të zbatimit të detyrave për zvogëlimin e riskut dhe fatkeqësive të mbrojtjes civile”. Kjo është e përgjithshme.

2: “Përbërja, detyrat dhe funksionet e Qendrave të Mbrojtjes Civile në Qark përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Pra, ka dy pika, njëra është e përgjithshme dhe tjetra thotë: do të bëjmë vendime qeverie, që t'ju japim disa detyra juve. Ne, si maxhorancë, kemi bërë një strategji me ndarjen e re administrative, por ju si ministri nuk e dini, që shkalla e parë e bashkive të jetë më e fortë, prandaj janë 61 bashki. Ne sot e kemi lënë nivelin e qarkut jo më shumë se 10 veta në çdo qark, me idenë për ta zvogëluar, por duhet të ndërhyhet në Kushtetutë, për të thënë se pushteti vendor duhet të ketë këto dy nivele: bashkia dhe zvogëlimi i qarkut. Mendoj se në momentin që ne kemi zvogëluar qarkun, jepen detyra kot, sepse nuk kanë asnjë vlerë.

**Ulsi Manja** – 10 veta janë në qark.

**Bashkim Fino** – Nuk ka vlerë, sepse fatkeqësia do të ndodhë brenda një bashkie.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Koordinimin e bën ti nga qendra, nëse do ta bësh, midis dy bashkive. Nëse fatkeqësia kap dy bashki rresht, do të jenë bashkitë, por do të jeni edhe ju.

Ti nuk e di sa detyra ka qarku dhe shprehesh: “me vendim qeverie”. Çfarë do t’i japësh qarkut me vendim qeverie? Ti thua: “përbërja dhe detyrat e funksionit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”, ndërkohë që ne 10 veta kemi lënë në qark. Çfarë do t’i japësh?

**Ulsi Manja** – Fjalën e ka relatori, zoti Leka, dhe më pas zoti Shehu.

**Edmond Leka** – Zoti kryetar, në nenin 16 propozojmë të hiqet germa “a”, që e përcakton Kuvendin si pjesë të strukturave të mbrojtjes, sepse janë struktura ekzekutive.

**Ulsi Manja** – Po, zoti Shehu.

**Ismail Shehu** – Për sa i përket komentit të parë, qendrat e mbrojtjes civile në qark janë struktura në varësi të agjencisë, të AKMC-së, por janë me seli në qark. Pra, nuk janë strukturë e qarkut, por të AKMC-së. Për të pasur një shtrirje territoriale në të gjitha qarqet, për të pasur një kontroll për menaxhimin e informacionit, për sinjalizimin, koordinimin e të tjera, do të jenë pjesë e AKMC-së, por me seli në qark. Pra, janë pjesë e pushtetit qendror, jo e pushtetit vendor.

Tek e dyta, ne kemi edhe një koment.

*(Diskutime pa mikrofon)*

*(Mungesë incizimi)*

**Ulsi Manja** – A mund të jepni një përgjigje për pyetjen e kolegut Leka?

**Ismail Shehu** – Për sa i përket çështjes së Kuvendit, kjo është një listë shteruese, ku çdo institucion shtetëror, nisur nga Kuvendi deri te bashkia, cilido që ka minimumin e kompetencës në çështjen e mbrojtjes civile, është listuar këtu. Ky është konceptuar si një ligj kuadër rregullator, ku çdo çështje që lidhet me mbrojtjen civile, do të orientohet në këtë ligj. Normalisht, të gjitha kompetencat ...

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Shehu!

Tryezës së komisionit iu bashkëngjitën zotërinjtë Koçi, zëvendësministër i Mbrojtjes, dhe zoti Çako, drejtor i Përgjithshëm i Emergjencave Civile.

Mirë se erdhët në komision!

Na gjetët në punë e sipër.

Kush ka diçka për nenin 16?

Po, zonja Mara.

**Aurora Mara** – Faleminderit, zoti kryetar!

Vendosja e këtyre institucioneve është në rend hierarkik apo thjesht vendosje? E bëj këtë pyetje, sepse problemi nis në momentin e një emergjence civile, sipas një rendi hierarkik. Cili ka prioritet, strukturat në qark, apo vetë bashkitë, prefekti, komisioni i mbrojtjes civile të qarkut? Sipas meje, problemi që lind në momentin e emergjencës, është prioritet i ndërhyrjes së dy institucioneve që janë në të njëjtin qark. Nëse vendosja është në rend hierarkik, problemi

është i zgjidhur, sepse më parë intervenon institucioni i qarkut, më pas intervenon prefekti dhe strukturat e tjera të qarkut. Nëse vendosja nuk ka ide hierarkike, problemi, sipas meje, lind vetëm në momentin e emergjencës. Cili do të ndërhyjë i pari: strukturat bazë në qark apo struktura përfaqësuese e qeverisë në qark?

**Ulsi Manja** –Faleminderit!

Zoti Shehu, keni ndonjë mendim të fundit, sepse do ta hedhim në votim nenin 16.

**Ismail Shehu** – Janë hierarkike për sa i përket rëndësisë së institucionit. Pra, Kuvendi, Këshilli Ndërministror e më pas të tjerët.

Më pas, në aspektin e kompetencave, ndërhyrja nis në fillim në bashki dhe në varësi të situatës mund të ndërhyjë edhe qendrori.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Patjetër.

**Ulsi Manja** – Ju lutem!

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ju lutem, kalojmë në votim!

Seksioni 1: “Institucionet dhe strukturat qendrore të mbrojtjes civile”.

Ky seksion nis me nenin 16 “Institucionet dhe strukturat qendrore të mbrojtjes civile”.

Kush është pro? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

**Bashkim Fino** – Jua thashë edhe një herë, më vjen keq! Ju nuk e kuptoni. Këtu është një burokraci e paparë. Sot në terren dhe në praktikë ndodh ajo që ju shikoni. Sa më shumë institucione të shtojmë, aq më pak ndihmë shkon te njerëzit që kanë fatkeqësi natyrore.

Unë do të isha më efektiv nëse ne do të kishim një agjenci kombëtare të mbrojtjes civile pranë Ministrisë së Mbrojtjes, çdo bashki të ketë agjencinë e vetë dhe koordinimi të jetë midis tyre. Nëse ato nuk kanë mundësi, siç thamë në nenin e mëparshëm, të ndërhyjë Ministria e Mbrojtjes me ndihmën e saj, sepse i ka në varësi.

Fakti që ju në çdo qark shtoni elemente, krijoni grupe, këshilla teknike, më duket sikur shtoni burokracinë për të mos i ardhur në ndihmë asnjë njeriu në fatkeqësi. Zoti kryetar, ata bëjnë një faturë financiare, që asnjëherë nuk realizohet dhe vonohet pafundësisht.

Unë jam kundër këtij neni, i cili duhet riformuluar dhe duhet bërë sa më efektiv. Ndoshta këta, si Ministri e Mbrojtjes, janë mësuar të bëjnë shumë vendime hierarkike, por do të ishte më mirë të ishte praktike, për t’ju ardhur në ndihmë njerëzve, dhe do të ishte shumë herë më mirë sesa 9 shkallët që janë vendosur, sepse, nëse i analizon pas nenit 17, nuk gjejmë asgjë.

E lexova nenin e qendrës së mbrojtjes civile në qark. Janë dy pika, që nuk kanë lidhje fare, një e përgjithshme dhe tjetra që thotë se do të dalë vendimi i qeverisë për t'i vënë disa detyra qarqeve. Mua më duket absurde. Pra, ne e vendosim si strukturë, do të vendosim disa njerëz, siç e tha përfaqësuesi i Ministrisë së Mbrojtjes, dhe do të jetë në qendër si seli e qarkut, por nuk do të ketë asnjë funksion dhe varet çfarë vendimi do të japë Këshilli i Ministrave. Zoti kryetar, duke qenë kundër kësaj, që është thelbi, sepse ky nen është shumë i rëndësishëm, ju sugjeroj të ndërprisni mbledhjen dhe ta rishikojmë edhe një herë nen për nen. Kam bërë një vërejtje në parim edhe për sa i përket 4%-shit të pushtetit vendor.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk jam kundër.

Të kam dëgjuar me vëmendje, zoti zëvendësministër, po edhe Kryeministrin, kur keni diskutuar në ministrinë tuaj për këtë projektligj. Absolutisht nuk jam kundër, që të gjitha institucionet duhet të marrin risqet e veta dhe bashkitë duhet të interesohen, të mos jenë pasive dhe përgjegjësinë të mos e ketë shteti.

Jam absolutisht dakord që duhet bërë një ligj ndërtues, por duhet të jetë edhe në funksion të ligjit të autonomisë së pushtetit vendor, i cili ka kaluar me 3/5-at dhe është më cilësor dhe më i rëndësishëm se ky ligj, që ndërhyt shteti. Vendosija e 4%-shit për çdo buxhet, për të cilin ju pyetja pse është 4% dhe jo 5% apo 3%, më duket ndërhyrje në buxhetin e bashkisë, ku ne nuk ndërhyjmë dot edhe kur u japim fonde të pakushtëzuara. Kur jep një fond të pakushtëzuar, për shembull: merri 100 lekë, i ke të pakushtëzuara nga buxheti i shtetit, këshilli përkatës i ndan sipas dëshirës së vetë për nevojat që ka; kur i jep një fond të kushtëzuar, është tjetër gjë. Për fondin e kushtëzuar unë do të thosha që duhet mbajtur, t'i thuash Bashkisë së Tiranës: urdhëro, ke 10 lekë vetëm për emergjencë civile nga buxheti i shtetit, por kjo duhet rregulluar, sepse ju nuk e keni kështu në ligj.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, zonja Bushka!

Kalojmë në nenin 17 dhe me votimin e këtij neni do ta ndërpresim mbledhjen, sepse në orën 13:00 kemi mbledhjen e Komisionit Hetimor Parlamentar.

Kush është pro me nenin 17?

**Ismail Shehu** – Zoti kryetar, ne propozojmë ta heqim nenin 17.

**Ulsi Manja** – Nuk kemi pse ta heqim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ky është ligj kuadër dhe Kuvendi ka detyra në kuadrin e emergjencave civile.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ismail Shehu** – Ka kompetenca që ia jep Kushtetuta, zoti kryetar.

**Ulsi Manja** – Duhet parë çfarë kompetencash ka Kuvendi në kuadrin e emergjencave civile, sepse jemi republikë parlamentare.

Kush është dakord me nenit 17?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nëse nuk je dakord, voto kundër!

Kush është dakord me nenit 17? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 17.

Këtu do ta ndërpresim mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Shqyrtimin, miratimin nen për ne dhe në tërësi do ta vazhdojmë nesër.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

